

ZGJEDHJET PARËSORE **LISTA APERTA** (LISTA E HAPUR)

*“NUK MBROJMË NJE IDE,
POR THEKSOJME NJE PRANI”*

Më 18 dhe 19 mars zhvillohen zgjedhjet për ripërtëritjen e përfaqësive të studentëve. Është e rëndësishme që, përveç pedagogëve, në çdo këshill të ketë një **prani reale të studentëve** që t'u kujtojë të gjithëve **pozicionin qëndror të studentit**: për të sjellë gjykimin tone mbi mësimdhënien, strukturat dhe financimet, për të vënë në dukje problemet dhe nevojat, për të propozuar zgjidhje.

Për çfarë votohet:

Do të ripërtërihen përfaqësuesit për: Këshillin e Administrimit të Universitetit, Senatin Akademik të Universitetit, Këshillin e ARDSU, Komitetin Sportiv Universitar, Komitetin për Mundësi të Barabarta, Këshillet e Fakulteteve dhe Këshillet e Kurseve të Diplomave.

Çfarë është LISTA APERTA:

Lista Aperta është një grupim jopartiak që lind për të theksuar një prani dhe jo një ide. Në fakt për ne politika universitare ka si privilegj kryesor individin, domethënë një **prani që vjen përpara politikës në vetvete** dhe që vepron, që ndërton brenda shoqërisë, brenda Universitetit. Një **prani që duhet të mbrohet, në mënyrë që Universiteti të jetë me të vërtetë një vend lirie dhe krahasimi**, në të cilin të jetë e mundur, të nisesh jo nga një ide mbi universitetin, por nga brendësia e ndjekjes së universitetit, nga eksperiencia personale, për të sjellë një kontribut të dobishëm për të gjithë. Është kjo ideja e pluralizmit që lëviz punën tone të përfaqësimit.

PËRSE PARËSORET:

Është për të mbështetur këtë rol kryesor që propozojmë **PARËSORET**. Përpara një ngjarjeje kaq të rëndësishme si zgjedhjet studentore, nuk mund të bëjme ndryshe veçse të propozojmë kandidaturën për këdo që është i interesuar për vendin në të cilin studion.

Ku, si, kur:

Nga 3 deri më 9 shkurt për të paraqitur kandidaturën dhe për të marrë pjesë tek parësoret. Për të njohur oraret e sporteve nëpër fakultetet e ndryshme konsultohu me sitin www.firenze.listaperta.it

Lista Aperta



www.firenze.listaperta.it